



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2024/1012

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Vedat Poterqoi - Kryetar, Batisha Ibrahimimi dhe Kimete Gashi - Anëtare, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) AAB CONSTRUCTION SH.P.K., kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit të KOMUNA SUHAREKË në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit Ndërtimi i salles sportive ne SHFMU Vëllëzrit Frashëri - Bukosh - RITENDER me numër të prokurimit 624-24-7542-5-2-1, me 14.01.2025, mori:

Vendim

1. **Aprovohet**, si pjesërisht e bazuar ankesa e OE AAB CONSTRUCTION SH.P.K. me nr. 2024/1012 , e datës 18.10.2024, kurse vendimi i AK KOMUNA SUHAREKË lidhur me aktivitetin e prokurimit Ndërtimi i salles sportive ne SHFMU Vëllëzrit Frashëri - Bukosh - RITENDER me numër të prokurimit 624-24-7542-5-2-1, **mbetet në fuqi**.

2. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik AAB CONSTRUCTION SH.P.K.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Me 13.08.2024 KOMUNA SUHAREKË në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit Ndërtimi i sallës sportive në SHFMU Vëllëzrit Frashëri - Bukosh - RITENDER me numër të prokurimit 624-24-7542-5-2-1.

Me 04.10.2024, AK (me të dhëna si më sipër) ka publikuar Njoftimi mbi vendimin (B58) ku ka shpërblyer me kontratë OE “NBT-ING SH.P.K.; N.N.P. EURO CONSTRUCTION”.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur, me llojin e kontratës punë me vlerë të kontratës 305,000.00 euro.

Me 08.10.2024 OE AAB CONSTRUCTION SH.P.K., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim. Ku Autoriteti Kontraktues me 09.10.2024 ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 18.10.2024, OSHP ka pranuar ankesën nga OE AAB CONSTRUCTION SH.P.K., me numër protokolli 2024/1012 lidhur me aktivitetin e prokurimit Ndërtimi i sallës sportive në SHFMU Vëllëzrit Frashëri - Bukosh - RITENDER me numër të prokurimit 624-24-7542-5-2-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues AAB CONSTRUCTION SH.P.K., janë parashtruar si në vijim:

Autoriteti Kontraktues Komuna e Suharekës me datën 04.10.2024 ka bërë publikimin e Njoftimit mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues, ku, në mënyrë të kundërligjshme, na ka eliminuar dhe ka rekomanduar për kontratë një OE më të shtrenjtë se ne, në shumën gati mbi 22,622.50 € të papërshtatshëm dhe të papërgjegjshëm, i cili nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e AK-së të vendosura në NJK dhe DT.

Së pari po e faktojmë përgjegjshmërinë tonë dhe kundërligjshmërinë e AK-së për të na eliminuar ne. AK ka publikuar njoftimin si më poshtë: Ndërsa si arsye të eliminimit AK e ka cekur se:

Autoriteti Kontraktues në këtë procedurë të tenderimit na ka eliminuar, pasi fatura e blerjes së kompresorit të ofruar me rastin e ofertuar nuk korrespondon me datën e transaksionit të blerjes si dhe faturës së blerjes, ndërsa Autoriteti Kontraktues në bazë të ligjit:

Ndërsa në rast të ndonjë dyshimi, AK-ja është dashur të sqarohet me ne sipas nenit 59 dhe 72 të LPP-së, që të kërkonte edhe informata shtesë për dokumentet e prezantuara, edhe në rast se ka qenë i gabuar, apo jo i plotë, gjithmonë për dokumentet të cilat janë ekzistencë dhe të fiksuara.

Sipas Neni 72 të LPP-së më saktësisht të paragrafit 2, ku kemi: “Autoriteti Kontraktues mund të ftojë Operatorët Ekonomik për të plotësuar apo të qartësojë certifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65 të këtij ligji” apo/ose të veprojë siç e përcakton edhe neni 52, neni 7 i LPP-së, dhe të kryejë kontroll efektiv të informatave dhe dokumentacionit të tenderit.

Ku ne kemi ofruar edhe dëshmi të cilat janë të mjaftueshme se nuk përbëjnë bazë për eliminimin e kompanisë sonë.

Ndërsa neni 59.4 i LPP-së gjithashtu lejon Autoritetin Kontraktues që të pranojë ofertat, në rast të gabimeve ose paqartësive dhe në raste të devijimeve të vogla. Në të dyja rastet është një kusht që të mos jetë në aspektin material të njoftimit për kontratë/dosjen e tenderit, nuk janë prekur. Ndërsa duke u bazuar në Nenin 59-Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i tenderëve pika 2, që ju si AK keni mundur që të kërkonte sqarim me shkrim mbi cilindo nga aspektet e tenderit, në

mënyrë që të bëhet Ekzaminimi, Vlerësimi ose Krahësimi i tenderëve sipas Ligjit, Udhëzuesve dhe Rregulloreve.

E që në rastin konkret Autoriteti Kontraktues nuk ka kërkuar fare informatë shtesë, pasi që transaksioni i paguar është transaksion i pro-faturës me po të njëjtin numër si të pro-faturës, e cila është e datës 14.12.2019, datës edhe kur është kryer transaksioni, e që e gjeni edhe të bashkangjitur (profaturën), ndërsa pas pagesës së profaturës është ofruar edhe fatura e rregullt nga shitësi, e cila e gjeni në dosjen e dorëzuar. Ndërsa si dëshmi, ne kemi ofruar edhe Foto të paisjes me të dhënat në të, ku konfirmohet që paisja është në pronësi të anëtarit të konsorciumit.

Kjo procedurë është procedurë e ritenderuar dhe ky ritenderim ka ardhur si pasojë e Autoritetit Kontraktues, i cili me çdo kusht eliminon kompaninë tonë për pretendime të cilat fare nuk qëndrojnë, me të vetmin qëllim që ky projekt ti ipet për ekzekutim kompanisë së shpallur të përgjegjshme në njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues. Me vendimin e marrë, AK ka bërë shkelje të nenit 1 të LPP-së, ku thuhet se: Vendimet e AK-ve, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lartë të transparencës dhe të jenë në përputhje me kërkesat procedurale qenësore të këtij ligji. Ne pas vendimit të pranuar me datën 04.10.2024 kemi pasur qasje në dokumente zyrtare, ku në qasjen e cila ishte e kufizuar përshkak se kompania në fjalë kishte plotësuar Aneksi 3-Kërkesa për sekret afarist, mirëpo në qasjen përmes pamjes së disa dokumenteve në zyrën e prokurimit, si dhe dokumentet të cilat nuk janë sekret afarist që na janë ofruar, kemi parë që kompania në fjalë, e cila është shpallur fituese, është dashur që të eliminohet nga procedura dhe jo të shpallet fituese pasi që ka shkeljet si në vijim:

- Pas qasjes në dokumente, ne kemi parë gjithashtu që nuk është përmbushur kërkesa në njoftimin për kontratë dhe FTD-së, ku për pikën Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2- Kërkesa 5 - Një (1) inxhinier i diplomuar i elektros ose master i diplomuar me së paku 5 vite përvojë pune pas diplomimit. Dëshmia 5 - CV-a e nënshkruar nga vetë personi, Diploma, Kontrata e punës me punëdhënësin ose parakontratë mbi angazhimin për këtë projekt.
Në cilësinë e Inxhinierit të Elektroteknikës, kompania në fjalë ka prezantuar për inxhinier Kujtim Suka, ndërsa inxhinieri në fjalë në të njëjtën kohë është i angazhuar tek po i njëjti Autoritet Kontraktues edhe si Konsulent Individual për menaxhimin e kontratave në territorin e Komunës së Suharekës, në bazë të numrit të prokurimit: 624-24-4186-2-2-1.
Ku i bie që punët për të cilat do të kontraktohet kompania në fjalë, e që është i angazhuar inxhinieri, do të menaxhohen nga vetë inxhinieri nga ana e AK, e në rastin konkret ky është një konflikt interesi, si të tillë është dashur që të eliminohet dhe jo të favorizohet për nënshkrim të kontratës dhe të shpallet i suksesshëm.
Ndërsa e gjeni të bashkangjitur edhe njoftimin e publikuar nga ana juaj me datën 16.05.2024 si dhe kontratën e nënshkruar.
- Pas qasjes në dokumente, ne kemi parë gjithashtu që nuk është përmbushur kërkesa në njoftimin për kontratë dhe FTD-së, ku për pikën Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2- Kërkesa 7 - Paisjet e nevojshme për kryerjen e këtij projekti janë kërkuar: tre (3) eskavatorë, një (1) kamion mbi 10 ton, një (1) kamion me kran, një (1) kompresor ajri 7.5 Kw, një (1) makinë për ngjyrosje, dy (2) kamioneta për bartje të

materialit, një (1) ngarkues-ult, një (1) ngritës-lift platform deri në 10m, një (1) minigarkues me lopatë me rrota gome.

Pas qasjes në dokumente, ne kemi parë që kompania në fjalë për ngarkuesin e ulët ka ofruar vetëm faturan dhe fletëpagesën, ndërsa mungon DUD-i për këtë paisje.

- Me vendimin dhe sqarimet e dhëna nga ana jonë, shihet qartas që Komisioni i Prokurimit, sipas ligjit, do të duhej të ofronte më shumë informacion për ndihmë dhe sqaronte gabimet dhe pasqyrat që përmbajnë lëndë të dërguar me datën 04.10.2024.

Përgjigje në kërkesën për rishqyrtim: Pretendimi ankimor nr. 1 — AK qëndron prapa vendimit të tij, pra fatura e blerjes së kompresorëve nuk korrespondon me datën e transaksionit të blerjes. Konkretisht, fatura me nr. 20458/2019 të datës 16.12.2019 nuk korrespondon me transaksionin bankar të datës 14.12.2019. Pagesa e faturës është 44/19 e datës 14.12.2019. AK nuk mund të kërkojë sqarim shtesë në bazë të nenit 72 të LLP-së dhe udhëzuesit operativ për Prokurimin Publik, ngase është ofruar dëshmia (pra nuk është se nuk është ofruar një dëshmi), por kjo nuk është në bazë të kërkesës së AK.

Sa i përket pretendimit ankimor nr. 2 — Konflikti i interesit, sqaroj si në vijim: Çështja e “konfliktit të interesit” përmendet vetëm në paragrafin 1.75 të nenit 4 të Përkufizimeve, si dhe në paragrafin 1.3 të nenit 65 të LPP-së. Paragrafi 1.75 i nenit 4 të këtij ligji “konfliktet e interesit” i përkufizon si në vijim: “1.75 Konfliktet e interesit - çdo situatë në të cilën anëtarët e personelit të autoritetit kontraktues ose të ofruesit të shërbimeve të prokurimit, që veprojnë në emër të autoritetit kontraktues dhe janë të përfshirë në kryerjen e procedurës së prokurimit ose që mund të ndikojnë në rezultatin e asaj procedure, kanë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, një interes personal financiar, ekonomik apo ndonjë interes tjetër që mund të perceptohet si kompromis i paanshmërisë dhe pavarësisë së tyre në kontekstin e procedurës së prokurimit.” Sipas paragrafit 1, nën paragrafët 1.1 dhe 1.2 të nenit 65 të këtij ligji, “Operatori ekonomik nuk ka të drejtë që të marrë pjesë në një aktivitet të prokurimit ose të marrë pjesë në ekzekutimin e ndonjë kontrate publike, nëse Operatori i tillë Ekonomik, ndonjë punonjës, drejtues, menaxher ose drejtor i saj: 1.1 ka qenë pjesëmarrës në përgatitjen e njoftimit të kontratës ose dosjes së tenderit, ose në përgatitjen e ndonjë pjese të tyre, që shfrytëzohet nga autoriteti përkatës kontraktues; ose 1.2 ka pranuar ndihmë për përgatitjen e tenderit ose kërkesës për pjesëmarrje nga një person ose ndërmarrje që ka marrë pjesë në përgatitjen e njoftimit të kontratës ose dosjes së tenderit ose të ndonjë pjese të këtyre të fundit.” Dhe menaxheri i kontratës përcaktohet pas nënshkrimit të kontratës, dhe natyrisht që AK do të kujdeset që menaxheri i kontratës të zgjidhet nga njësia kërkuese dhe jo nga njësia tjetër ku është i angazhuar personi në fjalë.

Sa i përket pretendimit ankimor nr. 3 — nuk qëndron përkatësisht mos ofrimi i DUD-it për pajisjen në fjalë, AK ju sqaron se kërkesa e AK ka qenë ofrimi i DUD-it nëse nuk ekziston DUD-i, operatori ekonomik duhet të sjellë faturat e blerjes me dëshmi bankare, ku OE ka ofruar një dëshmi të tillë dhe ka plotësuar këtë kriter.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 22.10.2024 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 2024/1012, ndërsa me datë 31.10.2024 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues dhe teknik me nr. 2024/1012, me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk është pajtuar lidhur me rekomandimin e raportit të ekspertit shqyrtues, ndërsa OE është pajtuar lidhur me mendimin e ekspertit.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marrë parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritues lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e AAB CONSTRUCTION SH.P.K., eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2024/1012 ka vlerësuar si në vijim:

Pretendimi 1

OE ankues pretendon që: “AK na ka eliminuar nga kjo procedurë me arsyetimin se kinese fatura e blerjes së kompresorit të ofruar me rastin e ofertuar nuk korrespondo me datën e transaksionit të blerjes si dhe faturës së blerjes. Sqarojmë se transaksioni i paguar është transaksion i profaturës me po të njëjtin numër si të pro-faturës e cila është e datës 14.12.2019 datës edhe kur është kryer transaksioni e që e gjeni edhe të bashkangjitur (profaturën), ndërsa pas pagesës së profaturës është ofruar edhe fatura e rregullt nga shitësi, e cila e gjeni në dosjen e dorëzuar. Ndërsa si dëshmi në kemi ofruar edhe Foto të paisjes me të dhënat në të ku konfirmohet që paisja është në pronësi të anëtarit të koncersiumit. AK nuk ka vepruar sipas nenit 59 dhe 72 të LPP-së për sqarime shtesë.”

Eksperti shqyrtues sqaron se një nga kërkesat e kapacitetit teknik dhe profesional sa i përket pajisjeve ka qenë që operatorët ofertues të dorëzojnë me ofertë edhe një kompresor ajri 7.5Kw dhe si dëshmi duhet të ofrohet librezë apo dudi doganor. Për pajisjet të cilat nuk kanë dudi doganor duhet të ofrohen faturat e blerjes me dëshmi bankare. OE ankues në ofertën e tij për pajisjen kompresor ka dorëzuar faturën e blerjes dhe transaksionin bankar.

AK ka eliminuar OE ankues me arsyetimin se data në faturën e bashkangjitur nuk përkon me transaksionin bankar, përkatësisht data e faturës është datë dy ditë më e vjetër se sa dëshmia e transaksionit bankar. Eksperti, pas ngritjes së këtij pretendimi ka analizuar dokumentet e dorëzuara dhe sqaron se me ankesën e parashtruar është bashkangjitur edhe pro-fatura me numër 44/19 e cila përkon me datën dhe numrin e njëjtë të faturës ku është realizuar edhe transaksioni bankar, sipas sqarimit të operatorit ankues, fatura e rregullt është lëshuar dy ditë pas pagesës së pro-faturës, pra pagesa është bërë menjëherë me pro-faturë pa u pritur lëshimi i faturës së rregullt. Mendimi i ekspertit shqyrtues është se edhe pse sipas rregullave, pro-fatura është vetëm një faturë preliminare dhe pagesat duhet të realizohen përmes faturës, në rastin konkret kur operatori ka realizuar pagesën menjëherë, duke u bazuar në pro-faturë dhe e njëjta është dorëzuar me ankesë, edhe pse kjo pro-faturë është sjellur më vonë, konsiderojmë që mund të vërtetohet me transaksion bankar se ajo është lëshuar në datën e njëjtë kur është bërë edhe pagesa përmes

bankës. Përderisa data në këtë pro-faturë, numri i faturës dhe shuma përkojnë me pagesën e transaksionit dhe gjithashtu shuma në pro-faturë, emri i artikullit përkojnë edhe me faturën e rregullt të dorëzuar me ofertë, konsiderojmë që arsyetimi i AK-së për eliminimin e OE ankues për këtë pikë nuk qëndron, të paktën AK është dashur që këtë çështje ta sqarojë përmes nenit 72 të LPP-së. Mendimi i ekspertit shqyrtues është që OE ankues ka plotësuar kriterin e dosjes, duke i ofruar dëshmitë e kërkuara sipas FDT-së dhe konsiderojmë që ky pretendim është i bazuar.

Pretendimi 2

“Pas qasjes në dokumente ne kemi parë gjithashtu që nuk është përmbushur kërkesa në njoftimin për kontratë dhe FTD-së, ku për pikën Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale është angazhuar Inxhinieri i Elektroteknikës tek po i njëjti Autoritet Kontraktues edhe si Konsulent Individual për menaxhimin e kontratave në territorin e Komunës së Suharekës në bazë të numrit të prokurimit: 624-24-4186-2-2-1. Ku i bie që punët për të cilat do të kontraktohet kompania në fjalë e që është i angazhuar inxhinieri do të menaxhohen nga vetë inxhinieri nga ana e AK e në rastin konkret ky është një konflikt interesi si të tillë është dashur që të eliminohet dhe jo të favorizohet për nënshkrim të kontratës.”

Eksperti shqyrtues sqaron se në lidhje me pretendimin e dytë, AK-Komuna Suharekë me datën 16/05/2024 (datë para publikimit të njoftimit për kontratë për këtë aktivitet të prokurimit) ka publikuar njoftimin mbi vendimin e AK-së për aktivitetin e prokurimit me titull “Ofrimi i shërbimeve konsulente për shërbime të veqanta (konsulent individual) për menaxhimin e kontratave në territorin e Komunës së Suharekës - Lot2, Lot3, Lot5-RITENDER” dhe numër të prokurimit 624-24-4186-2-2-1, përmes të cilit si Konsulent Individual-Elektroteknikë për menaxhimin e kontratave është rekomanduar individ K.S. i cili është pjesë e listës së stafit profesional të OE të rekomanduar për këtë aktivitet të prokurimit.

Duke marrë parasysh që kontrata e fituar nga K.S. si Konsulent ka kohëzgjatje 20 muaj dhe i njëjti do të merret pikërisht me menaxhimin e kontratave atëherë eksperti sqaron se i mbetet AK-së që të vlerësojë nëse ka mundësi që të paraqitet konflikt i interesit, nga ana tjetër sipas kushteve të dosjes së tenderit për aktivitetin e menaxhimit, cilësohet se konsulenti do të jetë i angazhuar me orar të plotë me mundësi të punës edhe jashtë orarit dhe ditëve të vikendit që sipas ekspertit edhe në këtë pikë vështirësohet angazhimi i inxhinierit në këtë aktivitet, ku pritet që kohëzgjatja e tij të jetë 12 muaj. Megjithatë, sipas mendimit të ekspertit këto dy çështje mbeten në diskrecionin e AK-së.

Pretendimi 3

“Pas qasjes në dokumente ne kemi parë gjithashtu që nuk është përmbushur kërkesa në njoftimin për kontratë dhe FTD-së, ku për pikën Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2- Kërkesa 7, Pas qasjes në dokumente ne kemi parë që kompania në fjalë të dhënat për ngarkues-ulet ka ofruar vetëm faturën dhe fletëpagesën ndërsa mungon dudi për këtë paisje.”

Eksperti shqyrtues sqaron se sipas kërkesave të dosjes së tenderit, OE i rekomanduar për kërkesën numër 7 të kapacitetit teknik dhe profesional, përkatësisht për pajisjen ngarkues i ulët ka dorëzuar faturën dhe transaksionin bankar i cili përkon me faturën e dorëzuar. Sa i përket pretendimit se për këtë paisje nuk është ofruar edhe dudi doganor, eksperti sqaron që sipas kërkesave për dëshmi në FDT është cekur se në rastin e pajisjeve të cilat nuk kanë librezë dhe nuk ekziston as dudi doganor atëherë operatorët duhet të sjellin faturat e blerjes me dëshmi bankare. Andaj, sipas kërkesave për dëshmi, OE i rekomanduar ka dorëzuar dëshmitë dhe

vlerësojmë që ky pretendim i ngritur është i pabazuar.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli Shqyrtues duke i analizuar shkresat e kësaj lënde dhe veprimet e ndërmarra nga palët, deklaratat e tyre dhe provat e administruara gjatë rrjedhës së këtij aktivitetit të prokurimit, konsideron se gjetjet e ekspertit shqyrtues dhe mendimet e tij nuk janë në tërësi të pranueshme dhe se Paneli Shqyrtues me të drejtë e mori në përgjigjen e AK të dhënë në kundërtë raportit të ekspertizës, me çrast deklaroi se:

“Sa i perket pretendimit nr. 1 AK sqaron se qendron prane vendimit te marrurr me date: 04.10.2024 edhe pas arsyetimit te prenetimit nga eksperti i ekspertizes, ngase, pranimi i pro-fatures i ofruar nga OE në kerkesen per rishqyrtim do te bie ndesh me parimin e trajtimit te barabart te OE-ve gjate vlersimit të tenderëve dhe poashtu pranimi si e mirqen e nje pro-fature nga AK bjen në kurndershtim me nenin 59.4 te LPP-se I cili percakton se: ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve, është kompetencë dhe përgjegjësi e plotë e autoritetit kontraktues.

Gjithashtu sipas nenit 59 të këtij ligji, autoriteti kontraktues do ta konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë.

Kjo do të thotë se AK gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve, përcakton përgjegjshmërinë e tenderëve vetëm në bazë të kërkesave që i ka specifikuar në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë.

Dhe gjithashtu per nje document te till AK nuk konsideron qe mund te kerkohet sqarim shtesë ne perputhje me nenin 72 te LPP-se ngase deshmia (profatura) nuk eshte qe ka munguar por qe nuk eshte ofruar ne pajtueshmeri ose edhe nuk korespondon me kerkesen e AK te parashtruar ne FDT. Ne oferte OE e ka ofruar nje fatur dhe nje trasaksion banker I cili nuk korespondon me njeri tjetrin, ndersa me kerkesen per rishqyrtim ka ofruar nje pro-fatur qe prap se prap AK nuk mund ta merr si te mirqen ngase profatura perpos qe bie ne kundershhtim me kerkesen e AK e njejtja nuk siguron AK qe eshte bere trasaksion dhe eshte bler paisja ne menyre te rregullt.”

Paneli Shqyrtues në këtë rast vlerëson se AK ka vepruar drejtë me rastin e vlerësimit të ofertave ngase, edhe kërkesa e Dosjes së Tenderit ka qenë që për pajisjet që nuk kanë DUD doganor të sjellën faturat e blerjes me dëshmi bankare. Kjo kërkesë e DT, sikurse edhe për AK në këtë rast por edhe për Panelin Shqyrtues nuk është e rastësishme apo më pak e rëndësishme që të sjellët fatura e blerjes së pajisjes së bashku me dëshmi bankare, ngase është e vetmja dëshmi në këtë rast se kemi të bëjmë me një pajisje e cila është blerë në mënyrë të rregullt dhe një OE mund ta posedojë me të vërtet. Kështu që, Paneli Shqyrtues nuk mund ta mbështesë mendimin e ekspertit shqyrtues, si dhe nuk mund ta konsideroj pretendimin ankimor si të bazuar, ku profaturën dhe faturën e kualifikon si të barasvlershme. Ngase është më se e qartë se pro-fatura në ekonomi është lloj oferte e cila mund ti ofrohet kërkuarit duke i dhënë informacione të nevojshme klientit, duke përfshirë përshkrimin e produktit, çmimin e produktit, pra Pro-fatura

përdoret për të informuar klientin rreth kostos përpara se të lëshohet faturë e plotë. Po ashtu për dallim nga një faturë e zakonshme, pro-fatura nuk ka karakterin e një dokumenti tatimor të detyrueshëm dhe nuk përdoret për të regjistruar transaksionet tatimore.

Gjatë analizimit është vërejtur se transaksioni bankar i OE ankues i datës 14.12.2019, ka përshkrim “pagesa e faturës nr.44/19 data 14.12.2019”, e që është nuk korrespondon me nr. faturës së rregullt 20458/19, të datës 16.12.2019, e cila është e bashkangjitur në ofertë. Po ashtu, mund të vërehet se as te përshkrimi nuk është pagesa e pro-faturës, por është pagesa e faturës nr. 44/19, e që në fakt kjo faturë nuk po rezulton se ekziston fare (apo së paku nuk është ofruar nga ankuesi fare). E në bazë të kësaj AK duhet të veproj konform nenit 52.7 të LPP.

Andaj, mund të konstatohet se transaksioni bankar nuk e ka përshkrimin e nr. faturës së pagesës të njëjtë me faturën të cilën ankuesi e ka prezentuar në ofertë. Po ashtu, pro-fatura e ofruar me nr. 44/19 nuk ka ekzistuar në ofertë fare por është sjellur me ankesë dhe nuk është dokument që mund të vërtetohet në mënyrë objektive dhe ti plotësoj kushtet e nenit 72 të LPP, i cili citon; “*Sigurimi i informacionit që mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive*”. Tutje është i çuditshëm fakti pse nuk ekziston një faturë e rregullt me nr. 44/19, që do të ishte në përputhje me përshkrimin e transaksionit. Eksperti shqyrtues nuk merret fare me këtë çështje.

Ndërsa sa i perket pretendimit ankimor Konfliktit të interesit AK e konfirmon se është mjaftë e vetëdijshme se Çështja e “konfliktit të interesit” përmendet vetëm në paragrafin 1.75 të nenit 4 Përkufizimet ,si dhe në paragrafin e 1.3 të nenit 65 të LPP-ës. Dhe se menaxheri i kontratës përcaktohet pas nënshkrimit të kontratës dhe natyrisht që AK do të kujdeset që menaxheri i kontratës do të zgjidhet nga njësia kërkuese dhe jo nga njësia tjetër ku është i angazhuar personi në fjalë. Përndryshe lidhur me çështjen e konfliktit të interesit secili person mbanë përgjegjësi individuale dhe secila palë nëse e konteston një gjë të tillë ti drejtohet Agjencisë për parandalimin e korrupsionit e cila është edhe mbikëqyrëse e Ligjit mbi Konfliktin e Interesit.

Lidhur me pretendimin tjetër ankimor të tretin me radhë të radhitur sikur në raportin e ekspertizës, sa i përket përmbushjes së kërkesave të DT nga ana e OE të rekomanduar për kontratë, PSH këtë pretendim e kualifikon si të pabazuar për faktin se OE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar dëshmitë konform kërkesave të DT, andaj edhe e mbështetë konstatimin e ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe përgjigjen e AK të dhënë karshi raportit të ekspertizës, vlerëson se ankesa e Operatorit Ekonomik duhet të aprovohet si e pjesërisht e bazuar. por e cila është e pamjaftueshme që të anuloj vendimin e AK. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur tëmbetet në fuqi Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues

Komuna e Suharekës, lidhur me aktivitetin e prokurimit, me titull “Ndertimi i salles sportive ne SHFMU Vellezrit Frasheri - Bukosh - RITENDER” me numër të prokurimit 624-24-7542-5-2-1.

Paneli Shqyrtues vlerëson se AK duke u bazuar në nenet 59 dhe 60 të LPP ka rekomanduar OE me ofertën më të lirë të përgjegjshëm vendim ky i cili është nxjerrë nga një komision i vlerësimit i cili supozohet të jetë profesional konform nenit 59 par. 1 te LPP-së, ku thote: *“Të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin e kryer të ofertës”*, atëherë bazuar në të lartcekurat, Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK, lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në këtë rast përbejnë bazë të mjaftueshme që te mbetet ne fuqi vendimi i AK.

Paneli Shqyrtues thekson se secili autoritet kontraktues (në nivelin qendror dhe lokal) gëzon autonomi në planifikimin e prokurimit (neni 8) dhe në përcaktimin e nevojave që duhen përmbushur (neni 9), natyrisht ne pajtim me kapacitetin buxhetor dhe se AK në rastin konkret ka pasur të drejtë të vendos po ashtu edhe për OE të rekomanduar për dhënie të kontratës bazuar edhe në neni 24 paragrafi 2 të LPP cituar “Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj”.

Përfundim –

Bazuar në kompetencat e OSHP të parapara me nenin 105, lidhur me nenin 106 të LPP, Paneli Shqyrtues vuri në zbatim mes tjerash dhe nenin 103 të Ligjit të cituar sipas të cilit të gjitha palët e interesuara do të kenë qasje të barabartë në procedurat për shqyrtimin e prokurimit dhe në mjetet juridike dhe se, asnjë vendim i OSHP, nuk do të merret ose bëhet në mënyrën me të cilën diskriminohet në të mirë ose në dëm të një pjesëmarrësi në procedurë ose të një personi ose ndërmarrje tjetër.

Paneli sqaron se përveç nenit 1,7,27,28 dhe 59 të Ligjit për Prokurim Publik, është e rëndësishme të theksohet se të gjithë ofertuesit janë të vetëdijshëm për procesin e aplikimit dhe dorëzimit të dokumentacionit në përputhje me dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë. Kanë përvojë të mjaftueshme në këtë fushë dhe janë pjesëmarrës të vazhdueshëm nëpër tendere që publikohen në Republikën e Kosovës, duke kontribuar në një aplikim të ndershëm dhe të drejtë për të gjithë.

Kjo siguron një garë të barabartë dhe të drejtë për të gjithë ofertuesit dhe shmang ndikimin në prolongimin e procedurave të prokurimit, me “kërkesa për sqarime të vazhdueshme nga ofertuesit” për dokumentacionet të cilat vazhdimisht i procedojnë për aplikime në ofertat e tyre. Andaj, paneli sqaron se në këtë rast përgjegjësia bie mbi ofertuesin, i cili tenderon për të fituar. Sepse është evidente dhe e njohur për të gjithë, se në çdo rast të njoftimit për kontratë, secili ofertues i cili nuk posedojnë “pajisjet adekuate” apo "kërkesa që mund të jenë diskriminuese apo të paqarta", do duhej që në fazën paraprake (para ofertimit), ti kundërshtoj të njëjtat apo eventualisht të parashtrijë pyetje apo të kërkojë sqarime nga AK

Në këtë kontekst edhe sipas gjykimit të pavarur të këtij paneli, AK por as OE, nuk duhet të thirren në dispozita nënligjore që të kërkojë sqarime shtesë për dokumentacionin e ofertuesve në çdo rast, pasi siç u sqarua si më sipër të gjithë ofertuesit janë të vetëdijshëm për detyrimet dhe procedurat e aplikimit nëpër tenderë. Kërkesa e ankuesit për plotësimin e dokumentacionit nuk duhet të shihet si një arsye e vlefshme për të ndërhyrë në procesin e prokurimit në mënyrë të pamjaftueshme të arsyeshme dhe duke ndërhyrë në punën e AK pa ndonjë provë dhe të rrezikoj edhe përmbushjen e nevojave të AK dhe rrezikimin e implementimit të kontratës. Secili e sidomos autoriteti kontraktues duhet të siguron që procedurat e prokurimit të mbeten efikase dhe të përmbushin qëllimin e tyre të sigurimit të kontratave publike në mënyrë të rregullt dhe të drejtë për të gjitha palët e interesuara. Po ashtu, vlenë të theksohet edhe fakti se neni 72 i LPP, nuk i vë karakter detyrimi AK që të kërkojë sqarime, ngase ka shprehjen "mund".

Paneli sqaron se po ashtu se në vështrim të kërkesave të autoritetit kontraktues të cilat precizohen në dosjen e tenderit dhe si të tilla bëhen publike për të gjithë ofertuesit eventual, secili duhet të udhëhiqet nga parimi i kujdesit në përmbushjen e kushteve formale në kohë dhe brenda afatit, kurse kthimi i një aktivitetit të prokurimit në mungesë të provave jo kontestuese nuk ofron bazë ligjore për ri-vlerësim eventual të tij dhe nuk është në harmoni me nenin 1 dhe nenit 7 të LPP.

Në fakt synimi i këtij aktiviteti të prokurimit i referohet dhe nenit 104 paragrafi 4 i LPP, sipas të cilit në ndërmarrjen e masave të përcaktuara në këtë Pjesë IX, OSHP duhet (i) të veprojë sa më shpejtë që të jetë e mundshme, të veprojë në mënyrë proporcionale me shkëlqen e pretenduar ose çështjen për të cilën është paraqitur ankesa dhe të marrë për bazë pasojat e mundshme të veprimeve ose masave në të gjitha interesat që mund të dëmtohen, duke përfshirë interesin publik përderisa po ky aktivitet i prokurimit i është nënshtruar dy here procesit të rivlerësimit.

OSHP niset gjithnjë nga fakti se çdo AK (në çdo nivel) gëzon pavarësinë e plotë në ushtrim e kompetencave dhe caktimin e nevojave në harmoni me kapacitetet buxhetore. Prandaj nisur nga të lartcekurat dhe duke i administruar me kujdes të gjitha provat e bashkëngjitura në shkresat e kësaj lënde, Paneli Shqyrtues ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi i bindur se ka aplikuar zgjidhjen e duhur konform legjislacionit në fuqi dhe natyrës së çështjes në rastin konkret duke e konsideruar po ashtu të drejtë dhe të arsyeshme edhe lejimin e mjeteve të deponuara në emër të tarifës ankimore, përfshirë dhe operatorët ekonomik të cilët janë provuar nga qasja në dokumente. Bazuar në të lartcekurat,

Paneli shqyrtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, në pajtim me nenin 117 të LPP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KOMUNA SUHAREKË**
- **OE - AAB CONSTRUCTION SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: